

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “Fan S. Noli” KORÇË
FAKULTETI I BUJQESISE**

Tel. & Fax. ++355 822 44489

**MIRATOHET
KRYETARI I KËSHILLIT SHKENCOR
Prof.as.dr.Irena KALLCO**

**RREGULLORE PËR STUDIMIN E DOKTORATURËS
NË KËRKIM TË GRADËS “Hortikulturë e qëndrueshme”**

**Miratuar në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Fakultetit
Me vendim Nr.____ datë _____**

Korçë, 2010

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e Studimeve Doktorale vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë për kryerjen e studimeve të ciklit të tretë për fitimin e gradës “Doktor në Hortikulture te qendrueshme”.

Rregullorja Studimeve Doktorale përcakton misionin e studimeve, organizimin e brendshëm dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat e palëve pjesëmarrëse dhe raportet midis tyre; procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikimet, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastet e shkeljes së rregullores.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm ligjor të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së studimeve të ciklit të tretë.

Neni 3

Bazat ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje janë Ligji Nr.9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 26, 42, vendimi nr.864, date 5.12.2007 “Për hapjen e programeve të studimit të doktoraturës në Arsimin e Lartë ne Republikën e Shqiperisel ...”, udhëzimi nr.5, datë 22.1.2008, udhëzimi në.20 datë 29.7.2009, udhëzimi nr.21, datë 30.7.2009 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, si dhe udhëzimi nr.39, datë 8.12.2009

Neni 4

Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, këshillat dhe komisionet, studentët doktorantë dhe palët bashkëpunuese të studimeve të ciklit të tretë.

KREU II

STATUSI, MISIONI DHE VEPRIMTARIA E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË

Neni 5

Statusi i studimeve të ciklit të tretë

5.1 Dekani i Fakultetit të Bujqësisë është drejtuesi i të gjitha studimeve të ciklit të tretë brenda fakultetit dhe ka në varësinë e tij të gjitha komisionet që drejtojnë programet përkatëse.

5.2 Çdo program studimi i ciklit të tretë drejtohet nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë , në Universitetin “Fan s.Noli” Korçë.

5.3 Studimet e ciklit të tretë në fushën e Hortikultures së qëndrueshme ofrohen si studime terminale.

5.4 Me përfundimin e suksesshëm të studimeve të ciklit të tretë në fushën e filozofisë së edukimit studenti fiton gradën: “Doktor në Hortikulture te qëndrueshme”.

5.5 Studimet e doktoraturës janë konceptuar si studime terminale, si stacioni i fundit i karrierës së njohur në fushën e studimeve hortikole.. Në përfundim të këtyre studimeve doktori i shkencave filozofike mund të punojë në sektorë publikë dhe privatë, ose të drejtojë grupe pune kërkimore.

Neni 6

Misioni i studimeve të ciklit të tretë

Fokusi i studimeve të ciklit të tretë është kërkimi shkencor, i cili ofrohet në atë masë sa kërkohet dhe në praktikë. Grada e doktorit synon të përgatisë specialistin e bujqesisë në fushën hortikole të veprorë në mënyrë të pavarur si kërkues shkencor, si drejtues, si ekspert i problemeve bujqesore në këto fushë .

Misioni i programit të studimeve doktorale është t’i përgatisë studentët dhe t’i aftësojë ata në çështjet e kërkimit të fushës përkatëse përmes aktivitetit kërkimor -shkencor.

Neni 7

Objektivat e studimeve

Doktori në Hortikulturë e qëndrueshme duhet :

Të zotërojnë një kapacitet për t’u përfshirë në kërkim shkencor të pavarur, në drejtimin e kërkimit shkencor dhe në vlerësimin e kërkimit shkencor për kuptimin dhe trajtimin e problemeve bujqesore si dhe aftësimin në transmetimin e dijes tek prodhuesit.

Të zotërojnë njohuri të thelluara shkencore që i kontribuojnë zhvillimit të bujqesisë kritik të individëve dhe grupeve shoqërore si dhe zhvillimin e aftësive komunikuese të dijes filozofike.

Të zotërojnë aftësi bashkëkohore për të luajtur rol drejtues në përhapjen e njohurive shkencore përmes trajnimeve .

Neni 8

Fushat e studimit

Studimet e doktoraturës në Hortikulture te qëndrueshme mund të realizohen në fushat e mëposhtëme:

1. Çështje aktuale të vizioneve e strategjive të zhvillimit hortikulturor te rajonit.
2. Trajtime teorike të thelluara mbi proceset e zhvillimit te qëndrueshem te bujqesisë hortikole.
3. Refleksione dhe kritika mbi zbatime te gabuara te modeleve te kultivimit. edukimi.
4. Vizione teorike dhe praktike rreth menaxhimit dhe drejtimit të procesit te prodhimit te kulturave hortikole.
5. Çështje problematike të rajonit .
6. Përgjithësim kërkimesh eksperimentale mbi hortikulturen e qëndrueshme
7. Studime të thelluara shpjeguese dhe zbatuese mbi. hortikulturen e qëndrueshme

Neni 9

Veprimtaritë gjatë studimeve të ciklit të tretë.

9.1 Aspektet kryesore të veprimtarisë gjatë studimeve të ciklit të tretë janë: ndjekja e kurseve, studimi i literaturës, shpjegime dhe komentime tekstesh nga autorët më kryesorë të bujqesisë , mësimdhënia me kohë të pjesshme, prezantimet, botimet.

9.1.2 Ndjekja e kurseve të studimit nënkupton marrjen e disa lëndëve, një pjesë të detyruara dhe pjesa tjetër që merret me orientim të Këshillit të Profesorëve.

9.1.3 Studimi i literaturës nënkupton studimin e të gjithë literaturës së mundshme në gjuhë të huaj, e cila përfaqëson kontributet më të njohura të autorëve që kanë kryer studime në fushën , në të cilën kërkon dhe studenti doktorat.

9.1.4 Angazhimi në probleme të bujqesisë me kohë të pjesshme. Kjo nënkupton detyrimin që studenti doktorat të japë kontributin e tij në seminare trajnimi, konferenca etj. në fushat në të cilat ai kryen kërkimin.

9.1.5 Prezantimet nënkuptojnë paraqitje publike të arritjeve në studimin e çështjeve të caktuara përgjatë studimeve dhe mund të kryhen para departamentit gjatë orëve të punës në auditor ose në mjedise me publik të zgjedhur.

9.1.6 Veprimtaria botuese kryhet në përshtatje me fushën e studimit dhe nënkupton kalimin e produkteve të punës së studentit doktorat në një provë publike përpara se të gradohet.

Neni 10

Parimet

10.1 Studimet e ciklit të tretë zhvillohen në bazë të parimeve: të lirisë maksimale akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë, të efektshmërisë, të analizës kritike, të vetëfinancimit.

10.1.1 Liria akademike nënkupton mungesën e imponimit dhe të ndërhyrjes, të censurës dhe barrierave në praktikën e veprimtarisë akademike. Ajo shikohet si një parakusht për mendimin kritik, krijues si dhe avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.

10.1.2 Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetëregullimit dhe të pavarësisë administrative për përmbushjen e misionit akademik. Praktikisht, me propozimin e komisionit që i drejton studimet, departamenti përkatës që mbulon studimet e ciklit të tretë, miraton strategjitë e zhvillimit dhe programet mësimore, ngre komisione për realizimin e misionit të vet, propozon antarësime në shoqata dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare të fushës së studimeve, bashkëpunon me fondacione e agjensi vendase e të huaja që ndihmojnë në realizimin e misionit të studimeve që ofron, përzgjedh personelin akademik dhe jo akademik, përdor mjediset dhe pajisjet e departamentit dhe të fakultetit për realizimin e misionit të studimeve.

10.1.3 Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës për realizimin e misionit të studimeve. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit , vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit duke synuar ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së studimeve.

10.1.4 Efektshmëria nënkupton funksionimin në një mënyrë të tillë, që çon drejt realizimit të qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që gjërat të bëhen sipas një strategjie të parashikuar.

10.1.5 Parimi i efijencës nënkupton që studimet e ciklit të tretë në fushën e filozofisë së edukimit, të arrijnë rezultate më të mira me kosto më të pranueshme për studentin, duke përdorur burimet njerëzore, materiale dhe mjete në mënyrë optimale.

10.1.6 Parimi i vetëfinancimit nënkupton që studimet e ciklit të tretë në fushën e filozofisë t'i sigurojnë vetë të ardhurat e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarive të parashikuara dhe t'i përdorin ato në përputhje me sistemin rregullator në fuqi.

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

Neni 11

Struktura e studimeve të ciklit të tretë në fushën e bujqësisë

Në procesin e udhëheqjes së studentit doktorant aktivizohen pedagogë të Universitetit Fan.S.Noli Korce të Fakultetit të Bujqësisë dhe pedagoge të Universitetit Bujqësor Tirane Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit .Këto njësi realizuese e drejtuese kanë në varësi personelin akademik, personelin ndihmës, komisionet që ngrihen sipas nevojës.

Neni 12

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Studimeve të ciklit të tretë janë udhëheqësi, departamenti, Këshilli i Profesorëve. Këta kontrollojnë kolegjisht gjithë veprimtarinë akademike, administrative dhe financiare të studimeve të ciklit të tretë dhe marrin vendime për probleme të rëndësishme.

Neni 13

Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë

Këshilli i Profesorëve ngrihet sipas ligjit. Detyrat e tij janë:

Drejton punën për hartimin e politikave dhe të strategjive të kërkimit shkencor në fushat që mbulon.

Miraton planin e studimit doktoral për secilin student doktorant.

Rekomandon listën e lëndëve mësimore që duhet të zotërojë çdo student doktorant.

Merr në provim paraprak të gjithë studentët doktorantë që kanë mbushur kushtet për këtë nivel kërkimi.

Ndjek ecurinë e procesit të studimeve doktorale në gjithë aspektet e tij.

Cakton udhëheqësin e studentit doktorant.

Verifikon dokumentacionin e studentit doktorant.

Propozon përmirësime në gjithë procesin e studimeve doktorale.

Shqyrton aplikimet për studime doktorale dhe merr vendimet përkatëse.

Kryen vlerësimet e tezës së studimit.

Neni 14

Udhëheqësi i studentit doktorant

14.1 Udhëheqësi i studentit doktorant është një person që, si rregull, zotëron titullin profesor, ose profesor i asociuar.

14.2 Udhëheqësi i studentit doktorant ka këto detyra:

-të njohë gjithë kuadrin rregullator të studimeve të ciklit të tretë,

-të përdorë të gjitha resurset për të dhënë ndihmë maksimale për studentin doktorant,

-të ndihmojë studentin doktorant të ndërtojë platformën e studimit,

-të bashkëveprojë në një mënyrë profesionale, qytetare me studentin doktorant,

-të mbikqyrë punën e studentit doktorant e të japë në kohën e duhur ndihmën në parandalimin e problemeve.

Neni 15

Planifikimi i studimit doktoral

Planifikimi i studimit doktoral kryhet nga kandidati doktoral dhe i propozohet udhëheqësit të tij.

Plani i studimit përmban:

Listën e lëndëve të detyruara për t'u studiuar.

Listën e lëndëve që ai e formon vetë.

Mënyrën e vlerësimit të studimit të tyre.

Literaturën që do të studiohet në kuadër të studimit, platformën shkencore të studimit doktorat.
Ky plan studimi i shkon për shqyrtim Këshillit të Profesorëve dhe pas miratimit të tij merr formë përfundimtare.

Neni 16

Platforma e studimit doktorat

Studenti doktorant harton, në bashkëpunim me udhëheqësin , një platformë të studimit që ai do të kryejë. Kjo platformë kalon për miratim në Këshillin e Profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë. Këshilli e miraton atë ose bën rekomandime për përmirësimin e saj. Kopja e miratuar e platformës depozitohet në dosjen e studentit doktorant, e firmosur nga Këshilli i Profesorëve.

Struktura e platformës së studimit doktorat është si më poshtë:

1. Konturimi i fushës së studimit, zgjedhja dhe formulimi i problemeve kërkimore.
2. Reçensionimi i shkrimeve të përshtatshme dhe përcaktimi i kuadrit konceptual apo teorik.
3. Studimet e mëparshme rreth çështjes së kërkimit të ndërmarrë.
4. Formulimi i çështjeve themelore të kërkimit ose hipotezave . Ndërtimi i një kuadri operator.
5. Plani logjik i kërkimit, njësitë e analizës, kontrolli dhe verifikimi i studimit.
6. Metodat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, shpjegimit dhe interpretimit të rezultateve.
7. Bibliografia e punimit.

KREU IV

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

NENI 17

Kriteret për fitimin e statusit të studentit doktorant.

17.1 Aplikanti për studime doktorale e fiton statusin doktorat nëse për të Kolegji i Profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë Universiteti “Fan.S.Noli “ka marrë një vendim të tillë.

17.2 Për marrjen e vendimit mbi dhënien e statusit doktorat, Kolegji i Profesorëve bazohet në plotësimin e kriterëve të vendosura për këtë gjë.

17.3 Kriteret e përcaktuara që duhet të plotësojnë kandidatët për fitimin e këtij statusi janë:
Zotërimi i një diplome të Nivelit të Dytë .Zotërimi i një Çertifikate të studimeve Master i Nivelit të Dytë në fusha relevante.

Zotërimi i një titulli tjetër studimi i fituar jashtë vendit në fushën e bujqësisë ekuivalente me titullin Master i Nivelit të Dytë në fusha relevante.

Posedimi i një çertifikate të zotërimit të një gjuhe të huaj evropiane.

Dëshmi të eksperiencës dy vjeçare të punës post master.

Një punim filozofik me shkrim kryer më parë.

Nota mesatare të studimeve të ciklit të dytë mbi 8.

Dy referenca të lëshuara nga persona të fushës të nivelit Prof.Dr. të cilat konfirmojnë se kandidati i ka kapacitetet intelektuale e motivacionale për të përfunduar me sukses studimet doktorale.

Deklarimi nga kandidati i eksperiencës profesionale dhe i qëllimeve të karrierës.

Deklarimi nga kandidati i gatishmërisë për të mbuluar shpenzimet e doktoraturës.

Neni 18

Koha dhe e drejta e studimeve

18.1 Koha e rregullt e studimeve doktorale është tre vjet pa shkëputje nga puna, kurse koha maksimale e këtyre studimeve është katër vjet.

18.2 Dy vitet e para të studimeve doktorale shpenzohen për marrjen e disa lëndëve, për studimin e literaturës, për kërkime të thelluara dhe euridite, ndërsa viti i tretë për shkrimin e studimit doktoral.

18.3 Studenti që nuk arrin t'i përfundojë studimet brenda kohës trevjeçare, me kërkesën e këtij të fundit në Këshillin e Profesorëve, mund të përfitojë mundësinë e një viti shtesë i cili si rregull jepet kur këtë e kërkon ngarkesa që përmban kryerja e studimit doktoral.

Neni 19

Paraqitjet publike të rezultateve të punës

19.1 Studenti doktoral paraqet publikisht dy pjesë të punimit të tij doktoral në mbledhjen e Departamentit të Hortikultures.

19.2 Studenti doktoral ka detyrimin të botojë dhe të prezantojë punimet e tij në lidhje me kërkimin doktoral edhe në nivele ndërkombëtare sipas udhëzimeve në fuqi.

19.3 Studenti doktoral paraqitet para Këshillit të Profesorëve në provimin paraprak, i cili bazohet në verifikimin e punës së studentit doktoral. Forma e këtij provimi paraprak parcaktohet nga Këshilli i Profesorëve.

Neni 20

Etika e studimit doktoral

Studenti doktorat i përmbahet etikës më të lartë të kërkimit dhe të krijimit shkencor. Ai zbaton rregullat e mirënjohura për respektimin e autorësisë, të moskomplikimit e të plagjiaturës. Shkeljet në këtë drejtim marrin ndëshkimin më të ashpër, atë të ndërprerjes së studimeve doktorale.

Neni 21

Teza e studimit doktoral

21.1 Tezë e studimit doktoral konsiderohet titulli i kërkimit që studentin doktorant do të hartojë. Ajo si rregull, përfaqëson sipërmarrjen e kryerjes së një studimi për verifikimin e një teze të caktuar të pavërtetuar më parë, për hedhjen poshtë të një teze të njohur, ose për të modifikuar një tezë të propozuar më parë.

21.2 Për kryerjen me sukses të tezës jepen udhëzime të hollësishme që përfshijnë edhe formatin e saj.

21.3 Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së tezës studentin doktorat duhet të marrë vlerësime mbimesatare në të gjitha lëndët e caktuara, të ketë kaluar në nivelin mbimesatar në provimin paraprak dhe të ketë kompletuar në rregull dokumentacionin.

KREU V

MBROJTJA E TEZËS DOKTORALE

Neni 22

Procedura e vlerësimit

22.1 Mbrojtja e tezës doktorale bëhet para Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë.UK dhe te Fak te Bujqesise dhe mjedisit UBT

22.2 Mbrojtja e tezës është publike dhe në të mund të marrin pjesë personat e interesuar.

22.3 Studimi doktoral mund të fitojë maksimalisht 50 pikë.

22.4 Dhënia e pikëve për studimin doktoral është e fshehtë.

22.5 Rrëzimi i studimit doktoral i mundëson studentit të paraqitet sërish për mbrojtje vetëm pas një viti.

Neni 23

Dokumentimi i vlerësimeve

23.1 Të gjitha operacionet për mbrojtjen e studimit doktoral duhet të dokumentohen dhe dokumentacioni ruhet.

23.2 Në asnjë rast dokumentacioni në lidhje me vlerësimin e studentit doktoral nuk duhet të përmbajë korrigjime.

KREU VI

GRADIMI

Neni 24

Kushtet dhe procedura e gradimit

24.1 Për të fituar gradën “Doktor në Hortikulture te qendrueshme” studenti doktoral duhet të ketë përmbushur këto kushte:

- Marrja mbi nivelin mesatar e kurseve të detyruara dhe me zgjedhje të programit.
- Rezultati mbimesatar në provimin paraprak.
- Përfundimi dhe mbrojtja e sukseshme gojore e tezës së disertacionit.
- Përmbushja e kërkesave për prezantime në department dhe botime sipas udhëzimeve në fuqi.

24.2 Gradimi “Doktor në Hortikulture te qendrueshme” bëhet në çastin kur studentit doktorat kalon provën e mbrojtjes së tezës.

KREU VII

PRANIMI I STUDENTËVE DOKTORALË

Neni 25

Dokumentacioni i aplikimit

25.1 Dokumentacioni që duhet dorëzuar për aplikim për studime doktorale përmban:

- Formulari i plotësuar i kërkesës.
- Fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit, ose pasaportës
- CV personale dhe bibliografi të punimeve.
- Vërtetim nga qendra e punës nëse është i punësuar.
- Diploma universitare me listën e notave, e noteruar dhe e shoqëruar me origjinalen.
- Diploma ose certifikata të kualifikimeve të ndryshme pasuniversitare me listën e notave, të noteruara dhe të shoqëruara me origjinalen.
- Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj e noterizuar e shoqëruar me origjinalen (Dëshmi e provimit e lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës, TOEFL ose Cambridge IELTS, CPE, CAE).
- Listë botimesh e shoqëruar me fotokopje të kopertinave të botimeve ose të abstrakteve të tyre.
- Dy rekomandime nga prof. secila e mbyllur në zarf dhe e firmosur nga rekomanduesi.

- Deklaratë vetjake për përballimin e shpenzimeve të studimeve,
- dhe 3 fotografi me format pasaporte.
- Fletëpagesa e taksës së regjistrimit për konkurim prej 2000 lekë.

25.2 Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurim të dosjeve dhe me intervistë.

25.3 Organizimi i konkursit të pranimit bëhet nga Dekani i Fakultetit të Bujqësisë mbi bazën e Rregullores së Studimeve Doktorale .

25.4 Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga dekani i Fakultetit dhe Këshilli i Profesorëve . Vendimi merret me shumicë votash dhe me votim të hapur.

25.5 Kandidati që nuk është përzgjedhur mund t'i drejtojë ankesë Këshillit të Profesorëve dhe të marrë një përgjigje përfundimtare prej tij.

Neni 26

Proçedurat e pranimit

26.1 Pranimi i dokumentacionit

- Dokumentet për konkurim pranohen sipas njoftimit zyrtar për pranimin e aplikimeve.
- Dokumentet për konkurim dorëzohen nga i interesuari në Sekretarinë e Departamentit të Shkencave Sociale.
- Bashkë me dokumentet aplikanti dorëzon edhe fletëpagesën e kryer për regjistrim.
- Me dorëzimin e tyre aplikanti merr një certifikatë aplikimi.

26.2 Procedura e përzgjedhjes zgjat dy javë dhe ndahet në këto faza:

Faza e parë: Vlerësimi akademik i kandidatëve.

Përgjegjësi i departamentit ngre një komision, me të cilin studion dosjet e kandidatëve dhe veçon ata kandidatë që i plotësojnë kriteret për aplikim.

Faza e dytë: Intervistimi i kandidatëve.

Kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad- hoc, nëse shihet e arsyeshme, mund të intervistohen nga Këshilli i Profesorëve.

Faza e tretë: Përzgjedhja e kandidatëve fitues.

Këshilli i Profesorëve , komisioni ad- hoc udhezimi 39 shqyrton dosjet dhe vendos me votim të hapur për kandidatët fitues të statusit të studentit doktorant. Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.

Faza e katërt: Komunikimi i vendimit.

Në këtë fazë fakulteti i dërgon secilit kandidat një letër me njoftimin e vendimit të pranimit ose të mospranimit.

KREU VIII

STUDENTËT DOKTORANTË

Neni 27

Statusi i studentit

27.1 Me fitimin e statusit të studentit doktoral personit i jepet certifikata e regjistrimit si i tillë.

Kjo i jep studentit doktoral të drejtën e fillimit të punës për përgatitjen për mbrojtjen e tezës doktorale.

27.2 Studenti doktoral ka këto të drejta:

- Të përdorë të gjitha mjediset dhe pajisjet e departamentit dhe të fakultetit për qëllime që përputhen me mbrojtjen e tezës së studimeve doktorale.
- Studentët doktorantë kanë të drejtë të japin mësim të paktën për një semestër në grupet e studentëve të ciklit të parë ose të dytë. Qëllimi i mësimdhënies është të zhvillojë shkathhtësitë e mësimdhënies dhe trajnimit. Përmbajtja e lëndës që do të jepet mësim zgjidhet të jetë në përputhje me eksperiencën e studentit doktorant dhe qëllimet e tij të studimit. Kjo veprimtari kryhet nën drejtimin e një titullari të departamentit.
- Studentët doktorantë duhet të marrin eksperiencën e kërkimit. Për këtë ata mund të ndjekin kurse të avancuara në metoda të kërkimit bujqësor horticulture e qendrueshme ose mund të ndihmojnë si asistentë udhëheqës in e tyre nëse ai është duke kryer ndonjë projekt kërkimor. Në mungesë të kësaj, disertanti mund të përfshihet në kërkimin që kryen një titullar i departamentit që mbulon doktoraturën.
- Studentët doktorantë mund të zgjedhin për të ndjekur kurse studimi si pjesë e programit të tyre të studimit. Ata mund të zgjedhin deri në katër kurse të tilla në departament ose Universitetin “Fan S.Noli” Korçë. Ato përfshijnë dy kurse të lëndës që mbulon fushën e studimit dhe dy kurse në metoda të avancuara të kërkimit shkencor. Kurset e para duhet të përputhen me qëllimin e kërkimit doktoral, të jenë të nivelit master e lart dhe të përputhura me interes individuale të kërkimit. Dokumentacioni për ndjekjen e kurseve të zgjedhura vihet në dosjen individuale të disertantit.
- Nëse disertanti ka kredite të fituara më herët se pesë vitet e fundit, atëherë ato kredite duhet të rivlerësohen duke ngritur një komision të posaçëm. Kurset dhe kreditet e tyre konsiderohen të vlefshme nëse janë marrë brenda pesë vjetësh. Në këtë kërkesë përfshihet fakti se kurset e fituara dikur harrohen / ose ndryshojnë përmbajtje. Nëse kurset kanë ndryshuar përmbajtje atëherë ato nuk rivlerësohen dhe disertanti duhet t'i ndjekë sërish ato. Nëse i ka harruar ato, atëherë ai duhet të rijapë provimet për to.
- Nëse studentët e doktoraturës dëshirojnë të aktivizohen në mësimdhënie part-time të pagueshme përtej kohës që u kërkohet, kjo merret në konsideratë nga udhëheqësi dhe departamenti.
- Studentët doktoralë kanë të drejtën të njihen me rregulla dhe procedura të formuluarat qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik, të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik, të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin akademik dhe profesional.

Nenin 28

Përgjegjësitë e studentëve doktorantë

Studentët doktorantë kanë këto përgjegjësi:

- Të njohin dhe zbatojnë Rregulloren e Studimeve Doktorale të Fakultetit të Bujqësisë, pranë Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, kërkesat e planit të studimit dhe platformës për realizimin e tezës doktorale.
- Të shfaqin sjellje të lartë qytetarie, etikë të lartë profesionale dhe pjekuri në të gjitha ndërveprimet në fakultet dhe në universitet me drejtuesit, personelin akademik e administrative dhe studentët e tjerë.
- Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet sipas planeve të punës.
- Të shlyejnë të gjitha detyrimet ndaj fakultetit dhe departamentit në kohën e caktuar.

KREU IX MASAT DISIPLINORE

Neni 29 Shkeljet

29.1 Të gjitha veprimet e studentëve doktoralë që bien në kundërshtim me këtë rregullore dhe me misionin e studimeve doktorale të paparashikuara këtu, si për shembull, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, kopjimi, plagjatura në punime shkencore, aktet e rrugaçerisë, të vjedhjes, etj., janë të ndëshkueshme.

29.2 Ndaj personave që kryejnë këto veprime merren këto masa disiplinore:

- a.vërejtje me shkrim
- b.përgjashtim nga shkolla për një vit
- c.përgjashtim nga Universiteti “Fan S.Noli” Korçë.

29.3 Masa e parashikuar në pikën (a) merret nga udhëheqësi shkencor. Masa e parashikuar në pikën (b) merret nga Këshilli i Profesorëve dhe masa e parashikuar në pikën (c) merret nga Dekani i Fakultetit të Mësuesisë.

29.4 Të gjitha ndëshkimet mund të apeloohen në instancën më sipër, vendimet e së cilës janë të formës së prerë.

KREU X FINANCIMI I STUDIMEVE

Neni 30 Burimi i financimit

Studimet për “Doktor në Hortikulture të qëndrueshme ” kryhen me vetëfinancim. Të ardhurat e financimeve formohen nga tarifa e shkollimit e paguar dhe tarifa e regjistrimit për konkurim.

Neni 31 Administrimi i të ardhurave

Administrimi të ardhurave që krijon programi bëhet në bazë të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, udhëzimeve të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, vendimeve të Senatit të Universitetit dhe të Këshillit të Profesorëve.

Neni 32 Tarifa e shkollimit

32.1 Tarifa e shkollimit për studimet e ciklit të tretë përcaktohet nga Këshilli i Profesorëve dhe paguhet me dy pjesë.

32.2 Studentit doktorat që nuk kryen pagesën e tarifës së shkollimit në kohën e caktuar i hiqet e drejta për të vazhduar studimet.

32.3 Tarifa e regjistrimit për konkursin e pranimit është **5000 lek**.

32.4 Fletëpagesat e studentit doktorat shoqërojnë dokumentet e tij të studimeve doktorale.

32.5 Përdorimi i të ardhurave nga tarifa e shkollimit dhe tarifa e regjistrimit kryhet vetëm sipas parashikimit të bërë për të mbuluar shpenzimet për shërbime operative, për investime, për pagesat e personelit akademik, të personelit administrativ të programit.

Përfitimi i studentëve nga pagesa e tarifës së shkollimit përfshin: dokumentet zyrtare për ta, shfrytëzimin e bibliotekës, të internetit dhe pajisjet e tjera teknike dhe elektronike të studimeve. Kjo tarifë nuk mbulon shpenzimet individuale të shkollimit, si shpenzimet për tekste, për fotokopjim materialesh, për vizita studimore.

KREU XI MARRËDHËNIET ME PARTNERËT

Neni 33

33.1 Programi i studimeve të ciklit të tretë mund të mbështetet edhe në marrëdhënie me partnerë të tjerë. Këto marrëdhënie realizohen nëpërmjet dekanit të fakultetit.

33.2 Bashkëpunimi i programeve të studimeve të ciklit të tretë me institucionet dhe individët kryhet mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit të negociuara nga shkolla dhe të nënshkruara nga dekani i fakultetit.

KREU XII VLERËSIMI I CILËSISË

Neni 34

34.1 Programi i studimeve doktorale kryen çdo tre vjet vlerësimin e cilësisë.

34.2 Programi i studimeve doktorale kërkon akreditimin në periudhat e parashikuara me ligj.

KREU XIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

35.1 Kjo rregullore mund të përsoset e të korrigjohet gjatë punës në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër shkolla ose ndryshimet në strukturën e administratës, me anë të amendamenteve të ndryshme bashkëngjitur asaj me firmën e Këshillit të Profesorëve dhe të dekanit ose duke u ripunuar tërësisht. Një kopje e kësaj rregulloreje depozitohet në protokollin e Fakultetit të Buqësisë.

35.2 Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Këshilli i Profesorëve dhe dekani i fakultetit.

Aneks 1.

Struktura e tezës së doktoraturës

- 1- Teza e doktoratës duhet të shkruhet në times Neë Roman, 12 dhe hapësirë single.
- 2- Në kapakun e disertacionit, në krye majtas të vendoset stema e UK dhe djathtas stema e Fakultetit. Poshtë tyre shkruhet me gërma kapitale ; UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANËS; FAKULTETI
- Në mes shkruhet titulli i cili duhet të jetë i shkurtër dhe shprehës për çfarë bëhet fjalë në doktoratë. Poshtë titullit me spacio të madhe shkruhet emri dhe mbiemri i autorit, ndërsa në fund të faqes , në mes shkruhet viti i botimit (p.sh.Tiranë-2008)
- 3- Në faqen e dytë në pozicionin e sipërm shkruhet emri i departamentit, në pozicionin e 1/3 së faqes rishkruhet tiulli i disertacionit me gërma kapitale dhe shkrim 16.neë roman. Më poshtë, me spacio të trefisht, shkruhet emri i autorit në të majtë dhe firma e tij, ndërsa në të djathtë , udhëheqësi shkencor dhe firma përkatëse. Në n1/3 e fundit shkruhet data e mbrojtjes dhe emrat e antarëve të jurisë; përballë emrave të tyre lihet hapësirë boshe për vendosjen e firmës përkatëse (p.sh X.....Y.....)
- 4- Në faqen e tretë jepet, përmbajtja e disertacionit e cila duhet të jetë e detajuar; kapitujt, titujt dhe nëntitujt e cilitdo kapitull dhe numri korespondues i faqeve.
- 5- Hyrja të zerë 6-8 faqe. Në të jepet një panoramë e situatës se çfarë është arritur në atë fushë nga studiues të tjerë dhe konkretisht për problemin e marrë në studim nga disertanti. Në këtë ekspozitë, nëse ka mendime e rezultate të ndryshme, ato vihen në evidencë. Jepet shtypa për ndërmarrjen e studimit, qëllimi dhe objektivat përkatëse.
- 6- Në pjesën, materiali dhe metoda, përshkruhet me hollësi gjithë treguesit që do të studiohen si dhe metoda laboratorike e fushore për nxjerrjen e rezultatit, baza materiale e nevojshme, analiza ekonomike, analiza statistikore që i mbështet rezultatet etj. E gjitha kjo duhet të përfshihet në 15 - 20 faqe.
- 7- Rezultatet e diskutimi i studimit jepen në mënyrë kronologjike sipas renditjes së problemeve në pjesën e metodikës. Ato jepen në detaje dhe të ilustruara me tabelat grafikët dhe fotot përkatëse. Në paraqitjen e rezultateve mund të jepet dhe një interpretim i shkurtër për rezultatet më pikante të studimit. Diskutimi i rezultateve duhet të jetë sa më konçiz dhe të lejojë ballafaqimin e rezultateve të doktorantit me ato të literaturës. Në jo më pak se 30 faqe, doktoranti mban qëndrimin e vet, jep argumentet shkencore, vë theksin tek kontributi origjinal në studimin përkatës. Gjatë diskutimit të rezultateve dhe ballafaqimit të tyre me rezultatet e autorëve të tjerë, doktoranti i referohet literaturës në mënyrë sa më të qartë (psh. Sipas Lavel et al.- 2001)etj.
- 8- Përfundimet duhet të jenë konçize, të dalin vetëm vlerat origjinale të studimit, të mos ketë përsëritje.
- 9- Pas përfundimeve jepet literatura e shfrytëzuar në një kapitull më vete. Literatura e listuar duhet të jetë cituar në përmbajtjen e disertacionit.
- 10- Në fund të materialit mund të jepen në formën e anekseve; tabela, grafikë, skica e fotografi të shoqëruara komente të shkurtëra. Ato nuk duhet të jenë paraqitur më parë në materialin e doktoratës.

- 11- Në përbërje të tezës së doktoraturës mund të përfshihen si rubrika të vecanta edhe dedikime dhe falenderime të disertantit për persona që kanë ndihmuar në realizimin e studimit dhe përgatitjen e tezës së doktoratës.
- 12- Teza e doktoratës lidhet në formën e një libri në kopje të mjaftueshme. (është i detyrueshëm depozitimi i një kopje të tezës së disertacionit në Bibliotekën e UBT, Bibliotekën Kombëtare dhe në dosjen përfundimtare të përfundimit të shkollës së doktoraturës).
- 13- Krahas materialit të plotë të tezës së doktoratës, disertanti përgatit një përmbledhje të në rreth 30 faqe A5 në kopje të mjaftueshme, për të gjithë antarët e Këshillit të Profesorëve.
- 14- Kopja e përmbledhjes së tezës së doktoratës dhe një përmbledhje e zgjeruar në anglisht dorëzohen edhe në formën elektronike për tu paraqitur në faqen elektronike zyrtare të UBT.

Anex 2.

Dokumentacioni i detyrueshëm për aplikim në shkollën e doktoratës.

- Kërkesa me shkrim që përfshin fushën, drejtimin e studimit dhe departamentit që i drejtohet;
- Kopje të noterizuara të diplomave të studimeve të përfunduara dhe listat përkatëse të notave të tyre;
- Curriculum vitae;
- Dëshmitë për specializimet e mundshme dhe që kanë të bëjnë me kualifikimin e tij pasuniversitar;
- Dëshmitë për bashkepunimin me institucionet e tjera shkencore e private;
- Çertifikatë lindje me fotografi ose kopje pasaporte e noterizuar;
- Dëshmi penaliteti;
- Dy rekomandime të dhëna përkatësisht nga dy “Profesor” ose “Profesor i asociuar” të fushës përkatëse ose fushave të përfaqësuara;
- Dëshmia e gjuhës së huaj (një ose më shumë gjuhëve që përfshihen në udhëzimin e MASH) ose kopje e noterizuar e saj;

